



## REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr. 307/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit "Raffles" SH.P.K, me NRB 8101471827, me seli në Ternac, Skenderaj, e përfaqësuar nga L.H., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K.O. Avokat, me adresë Rr. Bulevardi Isa buletini 40000 Mitrovicë, kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Adresa. Rr. Armend Daci nr. 110000 Prishtine, kundër Aktvendimit me nr. 49/5. te datës 10.12.2019 dhe Aktvendimit KA. nr. 006/2020, te dt. 27.02.2020 te Komisionit te Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në seancë publike më datë 07.03.2024 në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, me pjesëmarrje të përfaqësuesit te autorizuar të paditurit Pleurat Gjata, më datë 29.03.2024 merr këtë:

### A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit "Raffles" SH.P.K, me NRB 8101471827, me seli në Ternac, Skenderaj, kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me të cilën ka kërkuar anulimin e Aktvendimit me nr. 49/5. te datës 10.12.2019 dhe Aktvendimit KA. nr. 006/2020, te dt. 27.02.2020 te Komisionit te Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), si e pa bazuar.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### A r s y e t i m

#### Historiku procedural

1. Me datë 15.04.2020 në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative paditësit "Raffles" SH.P.K, me NRB 8101471827, me seli në Ternac, Skenderaj, e përfaqësuar nga L.H., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson K.O. Avokat, me adresë Rr. Bulevardi Isa buletini 40000 Mitrovicë, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Adresa. Rr. Armend Daci nr. 110000 Prishtine, kundër Aktvendimit me nr. 49/5. te datës 10.12.2019 dhe Aktvendimit KA. nr. 006/2020, te dt. 27.02.2020 te Komisionit te Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), me propozim që të aprovet kërkesëpadi e paditësit si e bazuar te anulohet Aktvendimi i KPMM-së nr. 49/5 i dates 10.12.2019 dhe Aktvendimi KA.nr. 006/2020 i dt. 27.02.2020, të lirohet paditësi nga gjoba e shqiptuar ne shumen prej 5. 000.00 € dhe të kompensohen shpenzimet procedurale për përpilimin e padisë në shumë prej 208.00 € si dhe për çdo seance nga 270.40 €. Lënda është evidentuara me nr. A.698/20.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA 307/22.
3. Më datë 07.03.2024 u mbajt seancë e shqyrtimit kryesor në seancë publike në mungesë të përfaqësuesit të paditësit, avokatit K.O. nga Mitrovica sipas autorizimit të datës 11.03.2020, i cili ftesën për seancë e ka pranuar me datë 23.02.2024, ftesës nuk i është përgjigjur, mungesën nuk e ka arsyetuar, prandaj konform nenit 41 të LPK-së, u mbajt seanca në mungesë të palës të ftuar në mënyrë të rregullt dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesit te autorizuar të paditurit Pleurat Gjata, sipas autorizim të datës 07.03.2024.

#### Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësues i paditësit në padi, në pretendimet e dhëna në padi të datës 15.04.2020 ka theksuar se Aktvendimit me nr. 49/5. te datës 10.12.2019 dhe Aktvendimit KA. nr. 006/2020, te dt. 27.02.2020 te Komisionit te Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM), është i përfshirë në shkelje esenciale te dispozitave te procedurës, konstatim te gabuar apo jo te plote te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te drejtës materiale,

me arsyetim se paditësit "RAFFLES" SH.P.K. me numër te biznesit 810171827 me seli Ternac, Skenderaj, i është shqiptuar gjoba administrative në shumën prej 5.000.0 € (pese mijë euro), për zhvillimin e aktivitetit të jashtëligjshëm mineral pa posedim Lejes për Aktivitet te Veçante. Ankesa e parashtruar nga pala paditëse është refuzuar me Aktvendim K.A. nr. 006/2020 të dt. 27.02.2020, nga ana e te njëjti organ, pra është refuzuar nga organi i shkallës së parë por ankesën është dashur ta shqyrtoj organi i shkallës së dytë. Aktvendimi i ankimuar është marr me shkelje thelbësore të Ligjit të Procedurën e Përgjithshme Administrative. Arsyetimi nuk përmban arsye për faktet vendimtare të vlefshme për një aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm, arsyet janë kundërthënëse, të pa çarta të pa kuptueshme, jo të plote.

5. KPMM gabimisht e ka konstatuar gjendjen faktike sepse ndërmarrja "RAFFLES" SH.P.K., nuk është hasur duke zhvilluar aktivitet të jashtëligjshëm të minerar në fshatin Shupkovce ngase nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet. Ndërmarrja e ka marr parcelën për të cilën KPMM po pretendon se ka zhvilluar aktivitet të jashtëligjshëm me qira nga vakufi i Mitrovicës dhe në fillim kjo parcelë nuk ka qen fare në posedim të kompanisë paditëse dhe nuk ka pas mundësi të filloj procedurën e për marrjen e lejeve të autoritetet kompetente. Në momentin e marrjes me qira të kësaj parcele është porositur e gjithë makineria, kjo makineri ka arritur para marrjes së pëlqimit dhe lejeve të organet vendore lokale dhe qendror, andaj makineria është vendosur në parcelën të cilën e kompania e ka marr me qira. Edhe pse makineria është vendosur në parcelën e lartcekur nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet.
6. Paraprakisht paditësja filluar aktivitetet për pajisje me lejet paraprake të organet kompetente, me dt. me dt. 04.2.2015 ka marr Pëlqimin elektro energetik, ka filluar të komplettoj dokumentacionin shtesë nga Komuna e Mitrovicës, me dt. 18/04/2019 vërtetimin se nuk ka obligime tatimore të pa paguar në Komunën e Mitrovicës, ka marr pëlqimin nga KUR Mitrovicë dt. 18.04.2019, në Mars 2019 ka bere Elaboratin gjeometrik, me dt. 17/05/2019 nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm e Komunës së Mitrovicës, ka marr Kushtet ndërtimore, me dt. 22.05.2019 ka marr nga Komuna e Mitrovicës pozicionimin e Parcelës ndërtimore, prej Ministrinë Infrastrukturës dhe Transportit me dt. 14.08.2019 ka marr Vendimin për kyçje pastaj ka lidh Kontrate për Shfrytëzimin e Brezit Rrugorë me Ministrinë Infrastrukturës dhe Transportit me dt.

28.08.2019, me dt. 23.05.2019 është bere Kërkesa për leje te ndërtimit ne Komunën e Mitrovicës dhe me 02.10.2019, bashkangjitur Vendimin për leje ndërtimore e dt. 12.12.2019, Raporti i vlerësimit te ndikimit mjedisore tetot 2019, së bashku me formularin e kërkesës i dt. 11/10/2019 dhe Debati publik, të gjitha pëlqimet dhe veprime janë marr dhe janë dorëzuar ne KPMM dhe janë në pritje të licencës.

7. KPMM gabimisht e ka zbatuar te drejtën materiale, konkretisht nenin 79 paragrafin 4 te Ligjit Ligjin Nr. 03/L-163 ngase nga ana e kompanisë tone nuk është zhvilluar asnjë aktivitet i hulumtimit, shfrytëzimit apo ndonjë aktivitet i veçante. Prandaj i propozon Gjykatës të aprovon kërkesëpadinë e paditësit "Raffles" SH.P.K. NRB : 8101471827, si të bazuar, te anulohet Aktvendimi i KPMM-së nr. 49/5 i dates 10.12.2019 dhe Aktvendimi KA.nr. 006/2020 i dt. 27.02.2020, të lirohet paditësi nga gjoba e shqiptuar ne shumen prej 5. 000.00 € dhe të kompensohen shpenzimet procedurale për përpilimin e padisë në shumë prej 208.00 € si dhe për çdo seance nga 270.40 €.

#### Kundërshtimet e të paditurës

8. E paditura Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) në deklaratimet e dhëna në përgjigje në padi të datës 01.01.2024, në pretendimet e dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton padinë si të pabazuar, i propozon Gjykatës ta refuzoj padinë e paditësit "RAFFLES" SH.P.K. dhe Aktvendimi K.A nr. 006/2020 i datës 27.02.2020 me nr. prot. 1189 dt. 02.03.2020 i lëshuar nga KPMM të mbetet ne fuqi, me arsyetim se me datën 18.11.2019, Inspektorati i KPMM-se.
9. Deklaron se ne baze te autorizimeve dhe obligimeve qe dalin nga Ligji Nr.03/1-163 për Miniera dhe Minerale ne lidhje me aktivitetet e jashtëligjshëm minerare ka konstatuar se ndërmarrja "RAFFLES" SH.P.K. është hasur duke ushtruar aktivitet te jashtëligjshëm minerar. Inspektimi është bërë ne lokacionin e objektit minerar ne shatin Shupkove ne anën e djathte ne hyrje te tunelit ne Mitrovice. Gate inspektimit Inspektoret e Minierave kane konstatuar se "RAFFLES" SH.P.K, është hasur duke kryer aktivitet te jashtëligjshëm minerar pa posedimin e Lejes për Aktivitete te Veçanta

- Baze Betoni cili është ne kundërshtim me dispozitat materiale te pjesës së VI (gjashtë) te Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, duke pasur parasysh faktin se ne radhe te pare personi qe dëshiron te ndërmarrë aktivite te veçanta duhet te pajiset me Lejen për kryerjen e aktiviteve te veçanta dhe se vetëm atëherë do te mund ti ndërmarr aktivitetet minerare që përfshihen nga të drejtat dhe detyrimet e lejes se veçante e cila do ti jepte bartësit të lejes të drejtën ekskluzive duke iu nënshtruar kushteve dhe dispozitave te asaj leje.

10. Inspektorati i KPMM-se, gjate inspektimit ka përcaktuar edhe lokacionin me koordinata ku ndërmarrja "RAFFLES" SH.P.K, ishte duke ushtruar aktivitet te jashtëligjshëm minerar, ne lokacionin me këto koordinata: 1) Y7490093, X4748660, Z517, 2).Y7490079, X4748677, Z515, 3). Y7490092 X4748690, Z514, 4) Y7490070, X4748673, Z514. Makineria e angazhuar ne kryerjen e aktivitetit te jashtëligjshëm minerar ne vendin e ngjarjes ishte: Autocistern Mercedes me tabela 02-929-EA, Autocistern Mercedes me tabela 02-964-EX, Autocistern Mercedes me tabela 02-963-EA, Lopat Ngarkuese LIEBHERR 566, Lopat Ngarkuese LIEBHERR 574, Ndermarrja "RAFFLES" SH.P.K, ne ditën e inspektimit është urdhëruar me ane te urdhëresës për ndërprerjen e aktivitetit te jashtëligjshëm minerar dhe sekuestrimin e mjeteve te punës të lëshuar nga Inspektorët që menjëherë te ndërpres aktivitetin e jashtëligjshëm minerar sipas Raportit për aktivitetin e jashtëligjshëm minerar dt. 25.11.2019, nr. prot. 9599;Urdheresa për ndërprerjen e aktivitetit te jashtëligjshëm minerar dt. 18.11.2019; Raporti për Operim ilegal, dt. 06.12.2019 nr. prot. 9778.

11. KPMM ne pajtim me nenin 79 paragrafi 3, 4 dhe 5 te Ligjit 03/1-163 për Minierat dhe Mineralet, me d.10.12,2019 i ka shqiptuar gjobe administrative ne shume prej 5,000.00 €, per aktivitet te jashteligjshëm Minerar pa posedimin Lejes. Bordi i KPMM-së e ka refuzuar ankesën si të pabazuar me Aktvendim K.A nr.006/2020 të datës 27.02.2020 me nr. prot. 1189 dt. 02.03.2020. Me arsyetim se sipas konstatimit te gjendjes faktike nga Inspektorati KPMM-së në foto nga vendi i ngjarjes janë konstatuar pajisje duke u mbushur me materiale - beton. Andaj, i gjithë aktiviteti është ne kundërshtim me Ligjin për Miniera dhe Minerale Nr. 03/L-163 dhe është aktivitet ilegale. Aktvendimi i atakuar është ne pajtim te plote me ligjin material. Neni 79, 3, 4 dhe 5 i Ligjit me nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale.

## Provat e administruara

12 Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Aktvendimi me nr.KA.006/2020 të datës 27.02.2020, Aktvendimi me Nr.49/5 të datës 10.12.2019 nga KPMM, Pëlqim për rregullimin e dokumentacionit teknik, Pëlqimi elektro energjetik me nr.411 me datë 04.02.2019 të lëshuar nga KEDS, Elaborati gjeomekanik i paditësit Raffles Shpk, me datë mars 2019, për prodhimin e betonit të gatshëm, Pëlqim nga Kompania Ujësjiellësi Rajonal “Mitrovica Sh.a” me datë 18.04.2019, Kushtet ndërtimore të caktuara nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm-Komuna Mitrovicë, Kontrata mbi shfrytëzimin e brezit rrugor e lidhur në mes të M.I.T dhe paditësit Raffles shpk, Vendimi i M.I.T me nr.prot:8729 me datë 14.08.2019 me të cilën ipet pëlqimi për ndërtim paditësit Raffles shpk, Vendim për leje ndërtimore me nr.08-351/02-0110655/19 me datë 12.12.2019, Raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis nga Investitori Raffles shpk, me datë tetor 2019, Njoftim për debat publik, Vendim i MMPH-së me të cilin aprohet kërkesa e paditësit Raffles për impiantin për prodhimin e betonit në Shupkovc-Mitrovicë, Raporti për operim ilegal me nr.9778 me datë 06.12.2019, Raport tereni për aktivitetin e jashtëligjshëm minerar me nr.Prot:10982 me datë 19.11.2019, Urdhëresë për ndërprerje të aktivitetit të jashtëligjshëm minerar me nr. Ref:004KPMM me datë 18.11.2019, Raport nga KPMM me nr. Prot:9599 me datë 25.11.2019.

## Vlerësimi i gjykatës

13 Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, deklaratimet e përfaqësuesit të paditësit në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar. Pretendimi i paditësit se ankesa e parashtruar nga pala paditëse është refuzuar me Aktvendim K.A. nr. 006/2020 të dt. 27.02.2020, nga ana e te njëjti organ, wshtw e pabazuar sepse gjykata vlerwson se vendimi nw shkallw tw dytw wshtw marrw nga Bordi i KPMM-sw, ndërsa vendimi Aktvendimi i KPMM-së

nr. 49/5 i dates 10.12.2019 nw shkallw tw parw wshtw marrw nga Drejtori i KPMM-sw.

14 Me Vendimin e kundërshtuar KA nr. 006/2020, me date 27.02.2020 të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale refuzohet ankesa me Nr. 10265 di. 23.12.2019 nga "RAFFLES" SH.P.K me numër te biznesit 810171827 me seli Ternoc, Skenderaj, mbetet i plotfuqishëm Aktvendimi me nr. 4915 dt. 10.12.2019 për gjobe administrative në shume te përgjithshme prej 5,000.00 € (pese mije euro), për zhvillimin e aktivitetit te jashtëligjshëm minerar pa posedimin Lejes për Aktivitetet të veçantë minerar - Baze Betoni.

12. Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 84 të Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale i cili përcakton se: “Çdo vendim apo veprim i KPMM-së, Ministrisë ose cilitdo Autoritet tjetër publik i cili është marrë në bazë të autorizimit të këtij ligji i nënshtrohet edhe shqyrtimit administrativ dhe atij gjyqësor si dhe ankesës, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parapara në Ligjin për Procedurën Administrative.” dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: “Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.”

13. Sipas Raportit të KPMM-së me nr. Prot:9599 me datë 25.11.2019 është konstatuar se ndërmarrja "RAFFLES" SH.P.K. është hasur duke ushtruar aktivitet te jashtëligjshëm minerar. Inspektimi është bërë ne lokacionin e objektit minerar ne shatin Shupkove ne anën e djathte ne hyrje te tunelit ne Mitrovice. Gate inspektimit Inspektoret e Minierave kane konstatuar se "RAFFLES" SH.P.K, është hasur duke kryer aktivitet te jashtëligjshëm minerar pa posedimin e Lejes për Aktivitete te Veçanta - Baze Betoni. Inspektorati i KPMM-se, gjate inspektimit ka përcaktuar edhe lokacionin me koordinata ku ndërmarrja "RAFFLES" SH.P.K, ishte duke ushtruar aktivitet te jashtëligjshëm minerar, ne lokacionin me këto koordinata: 1) Y7490093, X4748660, Z517, 2).Y7490079, X4748677, Z515, 3). Y7490092 X4748690, Z514, 4) Y7490070,

X4748673, Z514. Makinaria e angazhuar ne kryerjen e aktivitetit te jashteligjshem minerar ne vendin e ngjarjes ishte: Autocistern Mercedes me tabela 02-929-EA, Autocistern Mercedes me tabela 02-964-EX, Autocistern Mercedes me tabela 02-963-EA, Lopat Ngarkuese LIEBHERR 566, Lopat Ngarkuese LIEBHERR 574. Gjykata vlereson se raportit i jane bashkangjitur edhe fotografite me makineri.

15 Me Urdhresë për ndërprerje të aktivitetit të jashteligjshëm minerar me nr. Ref: 004KPM me datë 18.11.2019, Ndërmarrja "RAFFLES" SH.P.K, ne ditën e inspektimit është urdhëruar me ane te urdhresës për ndërprerjen e aktivitetit te jashteligjshem minerar dhe sekuestrimin e mjeteve te punës të lëshuar nga Inspektorët që të ndërpres aktivitetin e jashteligjshëm minerar. Ndërsa, me Raport për aktivitetin e jashteligjshëm minerar dt. 25.11.2019, nr. prot. 9599 ndërmarrje i është shqiptuar gjobe në shume prej 5,000.00 €.

14. Gjykata vlereson se vendimi i kundërshtuar është në përputhje me nenin 1 dhe 2 par. 1 lidhur me nenin 3 par. 1, nën-par. 1.49 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale si dhe me nenin 32 të Ligjit nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, pasi që ky vendim është mbështetur në dispozita ligjore të cilat janë të aplikueshme në rastin konkret ndaj paditësit. Neni 1 i Ligjit për Minierat dhe Mineralet përcakton se: “Qëllimi i këtij ligji është promovimi në përputhshmëri me standardet e pranuarra mjedisore, i hulumtimit, nxjerrjes dhe pasurimit të Mineraleve përmes rregullimit dhe mbikëqyrjes së personave të angazhuar në industrinë minerare, lehtësimi dhe mbështetja e një pjesëmarrje dhe konkurrence më të madhe të sektorit privat në industrinë minerare, maksimalizimi i hulumtimit dhe shfrytëzimit të Mineraleve, si dhe rregullimi i mbledhjes, menaxhimit dhe arkivimit të dhënave gjeoshkencore për të mirën e Republikës së Kosovës” dhe neni 2 par.1 i LMM-së përcakton se: “1. Ky ligj zbatohet për të gjitha aktivitetet që përfshijnë hulumtimin, shfrytëzimin dhe/ose pasurimin e lëndëve Minerale në Republikën e Kosovës”, ndërsa neni 3 par. 1, nën-par. 1.49 5 / 8 përcakton se: “1.49. Aktivitetet e veçanta - nënkupton: - aktivitetet e hulumtimit që përfshijnë: shpimin, gërmimin, marrjen e mostrave në sasi të nevojshme, matjet gjeofizike, duke përfshirë shfrytëzimin e aeroplanëve ose metodave elektrike me voltazh të lart, operimin e makinerisë ose pajisjeve, dhe aktivitetet e ndërlidhura që ushtrohen më qëllim të hulumtimit dhe që fizikisht e ndryshojnë ose çrregullojnë sipërfaqen e tokës, -



shfrytëzimin e eksplozivëve për qëllime të shfrytëzimit ose hulumtimit të mineraleve; - fillimin e aktiviteteve të shfrytëzimit ose shfrytëzimit zejtar, - aktivitetet Minerale që përfshijnë; përdorimin ose operimin e makinerisë dhe pajisjeve, aktivitete të tjera që janë caktuar nga KPMM-ja; dhe - trajtimin, deponimin ose përpunimin e mineraleve duke përfshirë: përdorimin ose operimin e makinerisë dhe pajisjeve, përdorimin e reagensëve kimik dhe të tjerë, aktivitete të tjera që mund të përcaktohen nga KPMM-ja.” Gjykata konstaton se i padituri vendimin kontestues e ka mbështetur në nenin 79 par. 4 të Ligjit për Minierat dhe Mineralet i cili përcakton: “4. Nëse një person zhvillon aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit ose aktivitete të veçanta pa poseduar Licencën ose Lejen e nevojshme, KPMM do të nxjerrë urdhër përmes të cilit i shqipton këtij Personi një gjobë në shumën prej pesëmijë (5000) Euro për secilin aktivitet të këtyllë.”

15. Nga provat e administruara dhe gjendjen faktike të konstatuar, gjykata vlerëson se me rastin e inspektimit të bërë nga i padituri, me datë 18.11.2019 inspektorati ka konstatuar se aty ishte duke u punuar, prodhohej betoni, mbusheshin kamionët dhe shkonin në destinacion të caktuar, për çka i ka bashkangjitur edhe fotografitë prandaj nga kjo konstatohet se paditësi ka kryer veprimtari e cila i nënshtrohet Ligjit për Minierat dhe Mineralet dhe se për veprimtarinë për të cilën është hasur duke e ushtruar gjatë inspektimit (prodhimi i gypave të betonit), ku kërkohet që subjekti të jetë i pajisur me Leje për Aktivitete të Veçanta – Bazë Betoni, leje kjo e rregulluar në pjesën VI të Ligjit nr. 03/L-0163 për Minierat dhe Mineralet.

16 Gjykata vlerësoj pretendimet e paditësit se i njëjti i ka bashkangjitur: pëlqim për rregullimin e dokumentacionit teknik, Pëlqimi elektro energjetik me nr.411 me datë 04.02.2019 të lëshuar nga KEDS, Elaborati gjeomekanik i paditësit Raffles Shpk, me datë mars 2019, për prodhimin e betonit të gatshëm, Pëlqim nga Kompania Ujësjiellësi Rajonal “Mitrovica Sh.a” me datë 18.04.2019, Kushtet ndërtimore të caktuara nga Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm-Komuna Mitrovicë, Kontrata mbi shfrytëzimin e brezit rrugor e lidhur në mes të M.I.T dhe paditësit Raffles shpk, Vendimi i M.I.T me nr.prot:8729 me datë 14.08.2019 me të cilën ipet pëlqimi për ndërtim paditësit Raffles shpk, Vendim për leje ndërtimore me nr.08-351/02-0110655/19 me datë 12.12.2019, Raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis nga Investitori Raffles shpk, me datë tetor 2019, Njoftim për debat publik, Vendim i MMPH-së me të cilin aprovohet kërkesa e

paditësit Raffles për impiantin për prodhimin e betonit në Shupkovic-Mitrovicë, por gjykata vlerëson se dokumentacioni i kompletuar është kërkesë sipas Neni 38 të Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale si dhe me nenin 32 të Ligjit nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, ku parashihet se çka duhet të përmbaj kërkesa për leje të veçantë paragrafi 1. përcakton: Personi që kërkon të ndërmarrë aktivitete të veçanta duhet t'i dorëzojë KPMM-së një kërkesë të plotë për lëshimin e Lejes për kryerjen e aktiviteteve të veçanta në fjalë. Kërkesa duhet të dorëzohet në formën e paraparë dhe me taksën e paguar, dhe asaj i bashkëngjitet dokumentet e përcaktuara në këtë paragraf.

17 Neni 24 i LMM-së përcakton të drejtat dhe detyrimet e Licencës për hulumtim *1. Licenca për hulumtim i jep bartësit të Licencës të drejtën ekskluzive, - në përputhje me kushtet dhe dispozitat e Licencës për Hulumtim, dispozitat e këtij ligji (duke përfshirë të cilindo akt nënligjor të nxjerrë sipas autorizimit të këtij ligji) dhe çfarëdo Marrëveshje Relevante për të Drejtat Sipërfaqësore ose të drejtat sipërfaqësore të cilat i janë dhënë Bartësit të Licencës nga KPMM - që të kryej aktivitetet e specifikuar hulumtuese. Paragrafi 5. përcakton që KPMM mund të shqiptojë një gjobë administrative ose mjet tjetër në përputhje me Pjesën XIII të këtij ligji ndaj cilit do Bartësi të Licencës për Hulumtim për shkak të mos përputhjes me dispozitat e paragrafëve 2. deri 4. të këtij neni.*

18 Udhëzim Administrativ (KPMM NR. 02/2012) për Dënimet Administrative dhe Dënimet Mandatore përcakton dënimet për aktivitetet e përcaktuara: Neni 1 Personat juridik apo fizik që gjatë hulumtimit, shfrytëzimit apo përpunimit-pasurimit të lëndëve minerare-Leje për Aktivitete të Veçanta që veprojnë kundër Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale si edhe ligjeve të aplikueshme, do të dënohen sipas pikave të mëposhtme të këtij udhëzimi administrativ, DA012 *Në qoftë se personi juridik gjatë zhvillimit të punëve të minierave dhe të aktiviteteve të veçanta i shmanget projektit të lejuar, pa pëlqimin e mëparshëm të autoritetit licencues. 5,000.00 €*

19 Prandaj, Gjykata vlerëson se vlerëson se e padituri me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë i ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëzim

Administrativ (KPMM NR. 02/2012) për Dënimet Administrative dhe Dënimet Mandatore si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë. Nga provat e administruara nuk është vërtetuar një gjendje tjetër faktike nga ajo që i padituri e ka vërtetuar në procedurë administrative. Prandaj, Gjykata erdhi në përfundim se Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike në procedurë administrative si dhe ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur ka vendosur që të refuzoj ankesën e paditësit dhe ta vërtetoj vendimin e kundërshtuar.

20 Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me vendimin e kontestuar nga paditësi, ka vepruar në përputhje me nenin 86 të LPA-së si dhe në kundërshtim me nenin 32 të Ligjit nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, andaj bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale, gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.307/22, datë 29.03.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.